



Njësia Nr./Br./No. QI (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 295 Nr. ifaq./Br.istr./No. pr. 01

Date/Date/Date 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00169-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3541m² (tremijë e pesëqind e dyzet e një metra katror), zona kadastrale Çifllak, e evidentuar në posedim të P.SH.E Kosovës K.K.Rahovec.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 300m² (treqind metra katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak.
4. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
5. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.295/22
Me datë:30.03.2022

